

---



---

**DOKUMENTE E MATERIALE**


---



---

**NJË MBISHKRIM DYGJUHËSH I VITIT 1912 NË MUZEUN  
ARKEOLOGJIK DURRËS**

Në fondet e Muzeut Arkeologjik Durrës ruhet një mbishkrim dygjuhësh, greqisht dhe serbisht, gdhendur në një pllakë mermeri të bardhë me damarë gri, i një cilësie të mirë, me përmasa 0.615 x 1.165 x 0.03 (fig. 1). Pllaka është e lëmuar vetëm nga faqja e gdhendur, ndërsa pjesa e pasme është lënë e papunuar. Këndet e pllakës janë të harkuara. Nuk ruhet asnjë e dhënë mbi origjinën e objektit, kush e ka sjellë në muze dhe ku ka qenë ruajtur apo vendosur më parë. Nuk ruan gjurmë llaçi në pjesën e pasme, që të tregonte nëse ishte vendosur në një faqe muri; por këndet e harkuara mund të kenë shërbyer për t'u kapur me kllapa metalike.

Të dy mbishkrimet zënë hapësirë të barabartë, dhe ndahen nga njëri-tjetri me një kurorë dafine, me dy degë, bashkuar në mes të pllakës, duke zënë pothuaj tërë lartësinë e saj.

Teksti në greqisht (fig. 2):

ΑΝΑΣΣΟΝΤΟΣ ΣΕΡΒΙΑΣ  
ΠΕΤΡΟΥ Α! ΚΑΡΑΓΙΕΩΡΓΙΕΒΙΤΣ  
ΕΠΙ ΜΗΤΡΟΠΟΛΙΤΟΥ ΔΥΡΡΑΧΙΟΥ ΙΑΚΩΒΟΥ  
Η ΕΝ ΑΛΒΑΝΙΑ,  
ΣΟΥΜΑΔΙΚΗ ΣΕΡΒΙΚΗ ΣΤΡΑΤΙΑ  
ΥΠ' ΑΡΧΗΓΩ, ΣΥΝΤΑΓΜΑΤΑΡΧΗ, Δ. ΜΠΟΥΛΙΤΣ  
ΤΟ ΔΥΡΡΑΧΙΟΝ ΚΑΙ ΤΗΝ ΠΕΡΙΞ ΧΩΡΑΝ  
ΑΠΟ ΤΟΥ ΤΟΥΡΚΙΚΟΥ ΖΥΓΟΥ  
ΕΥΔΟΚΙΑ ΘΕΟΥ ΗΛΕΥΘΕΡΩΣΕ  
ΜΗΝΙ ΝΟΕΜΒΡΙΩ, 15 ΙΝΔΙΚΤΩΝΟΣ ΙΑ! 1912

Transkriptimi:

ανασσοντος Σερβιασ  
Πετρου α! Καραγιεωργιεβιτσ  
επι μητροπολιτου Δυρραχιου Ιακωβου  
η εν Αλβανια,  
σουμαδικη σερβικη στρατια  
υπ' αρχηγος συνταγματαρχη. Δ. Μπουλιτσ  
το Δυρραχιον και την περιξ χωραν  
απο του τουρκικου ζυγου  
ευδοκια θεου ηλευθερωσε  
μηνη νοεμβριω. 15 ινδικτωνος ια! 1912

## Përktimi:

*Mbreti (udhëheqësi) Serbisë, Pjetri I Karagjorgjeviç mbi mitropolitin Jakov i Durrësit, kjo në Shqipëri, ushtria serbe e Soumadisë nën komandën e kolonel D.Boulits, lroi Durrësin dhe hapësirat rrotull nga zgjedha turke. Me vullnetin (mirësinë) e Zotit, Muaji Nëntor indikti 15 viti 1912*

## Teksti në serbisht (fig. 3):

З а в л а д е с р п с к о г к р а њ а П е т р а I  
 К а р а њ о р њ е в и њ а , а п о д м и х т р о п о л и т о м Д р а ч к и м  
 Ј а к о в о м , с р п с к и ш у м а д и с к и а л б а н с к и о д р е д  
 П о д к о м а н д о м п у к о в н и к а Д . Б у л и њ а о с л о б о д и  
 Д р а ч и о к о л н е к р а ј е в е о д т у р с к о г ј а р м а  
 15 н о в е м б р а 1912 г о д .

## Përktimi:

*Në qeverisjen serbe të mbretit Petër I Karageorgjeviç, dhe të mitropolitit të Durrësit Jakov, skuadra serbe e Shumadijes dhe shqiptare nën komandën e kolonelit D.Bulina, lroi rrethinat e Durrësit nga zgjedha turke. 15 nëntor viti 1912.*

Mbishkrimi na ofron disa të dhëna me interes. Por para se të kalojmë në analizën e tyre, le të krahasojmë më parë dy versionet e mbishkrimeve.

Teksti greqisht ka 10 rreshta ndërsa ai serbisht 6 rreshta. Në të dy versionet fillohet me përmendjen e mbretërimit të Serbisë nga Pjetri I Karageorgjeviç, pasuar nga mitropolitin Jakov i Durrësit. Nga kjo pjesë fillojnë dallimet mes mbishkrimeve. Në versionin greqisht është parë e nevojshme të jepet detaji se qyteti ndodhet në Shqipëri, ndërsa në versionin serbisht ky shpjegim mungon.

Më tej, në rreshtin e pestë të mbishkrimit në greqisht kemi njoftimin mbi ushtrinë serbe të Shumadijes, ndërsa në mbishkrimin serbisht quhet « skuadra serbe e Shumadijes dhe shqiptare ». Pra shtohet fjala « shqiptare » në versionin serbisht.

Pason emri i drejtuesit të detashmentit, « koloneli D.Boulits » në greqisht, « D.Bulina » në serbisht. Vazhdimi i tekstit shfaqet i njëjtë, duke u përmendur lirim nga zgjedha turke e Durrësit dhe rrethinave. Por në versionin greqisht zgjatet më tej duke shtuar shprehjen « me vullnetin e Zotit », gjë që mungon në tekstin serbisht. Të dy mbishkrimet mbyllen me datën 15 nëntor 1912.

Qartësisht pjesa në greqisht e mbishkrimit është më e plotë dhe duket se është më e besueshme sesa ajo serbisht. Mbishkrimi shihet se është një përkujtimore e gdhendur me rastin e pushtimit të qytetit të Durrësit nga ushtritë serbe. Përkujtimorja fillon me përmendjen e qeverisë serbe nën mbretin Pjetër I-rë Karageorgjeviç (1903-1918) dhe vazhdon me tej me mitropolitin Jakov. Përmendja në kohën e ndodhjes se ngjarjes duhet kuptuar jo vetëm si ajo e dy personaliteteve të rëndësishme, por edhe si dy individë të përfshirë vetë në

ngjarjen e përmendur, ku mitropolitit duhet të jetë porositësi dhe shkruesi i teksteve.

Më tej përmendet rajoni Shumadija, i cili gjendet në pjesën perëndimore të Serbisë, qendra administrative e së cilës është Kragujevac. Përmendja e saj duket se ka ardhur si pasojë e përkatësisë së origjinës së skuadrës serbe që ka hyrë në qytet. Por prania e fjalës « shqiptare » në versionin serbisht a nënkupton se pjesë e trupës ushtarake ishin edhe shqiptarë dhe drejtoreshin nga koloneli D.Bulina apo se detashmenti serb i Shumadijës drejtohej nga një kolonel me origjinë shqiptare ?

Krahasimi i të dhënave me burimet arkivore serbe apo greke, do të kishte qenë ndihmesë e madhe për të kuptuar më qartë qëllimin e punimit të këtij mbishkrimi, por një gjë e tillë nuk është e mundur. Të dhënat që kemi arritur të kontrollojmë, nuk janë të mjaftueshme për të hedhur dritë plotësisht, por mund të përiqemi të interpretojmë informacionin. Në versionin greqisht, pasi përmendet emri i mitropolitit Jakov të Durrësit, jepet detaji se gjendet në Shqipëri. Kjo mungon në versionin serbisht. Më logjike duket mundësia që të kemi një vendosje të gabuar të termit Shqipëri, një rresht më pas, në versionin serbisht, duke e futur gabimisht tek informacioni mbi njësinë ushtarake. Nëse marrim parasysh se teksti greqisht është më i plotë, duhet të besojmë në këtë version, i cili nuk e përmend skuadrën « serbe e shqiptare », duke nënkuptuar kështu një problem në shkrimin e tekstit serb apo mungesën e njohurive të mjaftueshme për ta shkruar atë në mënyrë korrekte.

Por ajo që më së shumti tërheq vëmendjen, është data 15 nëntor. Për të kuptuar qartë se çfarë është kjo datë, duhet të shikojmë rrjedhën e ngjarjeve dhe të krahasojmë dokumentet historikë që njohim.

Shpallja e luftës nga ana e Malit të Zi kundër Turqisë në 8 tetor 1912, u pasua edhe nga Serbia e Bullgaria në 17 tetor, e një ditë më pas nga Greqia<sup>1</sup>. Në fillimin e luftës, si mbreti Nikolla i Malit të Zi edhe mbreti Pjetër i Serbisë deklarorin se do t'u sillnin lirinë shqiptarëve<sup>2</sup>.

Ismail Qemali zbarkoi bashkë me patriotë të tjerë në qytetin e Durrësit më 21 nëntor, duke synuar ngritjen e flamurit dhe shpalljen e pavarësië këtu<sup>3</sup>. Por bashkëpunimi mes autoriteteve osmane e dhespot Jakovit arritën ta pengojnë. Pas largimit të Ismail Qemalit, qyteti e shpalli pavarësinë në datën 26 nëntor, siç njoftonte paria e qytetit në telegramin drejtuar Ismail Qemalit<sup>4</sup>. Në një tjetër

<sup>1</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: "Toena", 2002, f. 503.

<sup>2</sup> *Po aty*, f. 505.

<sup>3</sup> *Po aty*, f. 509.

<sup>4</sup> *Po aty*, f. 510; *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, Tiranë: 1963, dok. nr. 7, f. 28. Dokumenti në origjinal në gjuhën turke mban datat 13 nëntor 1328 – 26 nëntor 1912.

telegram që mban datën 27 nëntor 1912 (14 nëntor 1328), dërguar nga paria e Elbasanit, njoftohet përsëri mbi ngritjen e flamurit në Durrës dhe mbi dërgimin e një komisioni nga qyteti bregdetar për në Krujë, që ishte pushtuar nga një repart serb<sup>5</sup>. Më pas, në telegramin e datës 28 nëntor 1912 (15 nëntor 1328), të kryetarit të komunës së Qukësit, drejtuar Ismail Qemalit, kërkohet të protestohet kundër pushtimit të Tiranës<sup>6</sup>. Ndërsa vetë Kryetari i Qeverisë së Përkohëshme do t'i dërgonte telegram komandës së ushtrisë serbe që kishte pushtuar Durrësin, në datën 29 nëntor 1912 (16 nëntor 1328)<sup>7</sup>.

Duke parë këtë dallim të qartë mes datës së mbishkrimit dhe datës së pushtimit që njihet nga burimet arkivore, lind pyetja se për cilën arsye është gdhendur ky mbishkrim dhe çfarë përfaqëson data 15 nëntor? Qartësisht, mbishkrimi është porositur nga personazhi i dytë i përmendur në hyrje të saj, pra nga mitropoliti i Durrësit Jakovi, i cili ishte i pranishëm në qytet përgjatë pushtimit turk. Me sa duket, ky individ duhet të ketë qenë në lidhje me komandën serbe ose me të dërguar serbë, dhe janë marrë vesh për të pritur hyrjen e forcave serbe në qytet. Bazuar në këtë marrëveshje të mundshme, mitropoliti ka porositur gdhendjen e këtij mbishkrimi. Mospërputhja e datës së mbishkrimit, 15 nëntor, me datën e pushtimit të qytetit nga ushtria serbe, mund të ketë dy interpretime:

1. Vazhdimësia e betejave nuk ka shkuar ashtu si ishte parashikuar nga mitropoliti dhe ushtria serbe, duke çuar në vonesën e trupave serbe në frontin e luftës dhe hyrjen e tyre në një datë më të vonë. Me sa duket, kjo vonesë e ka bërë të papërdorshme përdorimin e pllakës mbishkrimore, duke sjellë nevojën, ndoshta, për të porositur një të dytë. Falë këtij ndryshimi, mundet që pllaka e përdorur me datën e pushtimit nuk ruhet më, për arsye që nuk i njohim, por u ruajt ky mbishkrim i papërdorur, në ndonjë magazinë, për t'u gjetur më pas dhe sjellë në fondet e Muzeut Arkeologjik të Durrësit.

2. Një mundësi e dytë, më e komplikuar, lidhet me përdorimin e datave në bazë të kalendarit hënor të Hixhrit dhe atij Gregorian. Në telegramet e ruajtura që na informojnë mbi veprimet e ndryshme në qytet, hartuar në turqisht, shënohen dy datat, ajo e kalendarit hënor të vitit të Hixhrit, dhe ajo e kalendarit diellor Gregorian. Kështu, telegrami me të cilin Ismail Qemali proteston ndaj pushtimit të qytetit të Durrësit tek komanda serbe, mban datat 29 nëntor 1912 / 16 nëntor 1328. Mungon njohja e ndonjë telegrami, me të cilin paria e Durrësit të njoftojë Qeverinë e Përkohëshme për pushtimin e qytetit. Kështu, lind pyetja, nëse data reale e pushtimit ishte 29 nëntor 1912 / 16 nëntor 1328 apo kjo duhet marrë si data e protestës, ndërsa pushtimi mund të ketë ndodhur një ditë më parë? Kruja ishte tashmë e pushtuar në datën 27 nëntor 1912 / 14 nëntor 1328,

<sup>5</sup> *Qeveria e përkohshme e Vlorës ...*, dok.nr. 12, f. 30.

<sup>6</sup> *Po aty*, dok. nr. 27, f. 39.

<sup>7</sup> *Po aty*, dok. nr. 35, f. 43-44.

ndërsa Tirana ishte pushtuar në datat 28 nëntor 1912 / 15 nëntor 1328. Trupat serbe të nisura nga Kruja nuk do të mund të synonin më parë Tiranën, kur, për nga rëndësia strategjike, qëndronte shumë prapa Durrësit. Prandaj mendojmë se pushtimi i të dy qyteteve (Durrës dhe Tiranë), duhet të ketë ndodhur në të njëjtën ditë - 28 nëntor 1912 / 15 nëntor 1328. Ndërsa dërgimi i telegramit nga ana e Kryetarit të Qeverisë së Përkohshme për komandën serbe në Durrës, mendojmë se duhet të ketë ndodhur një ditë më pas, më 29 nëntor 1912 / 16 nëntor 1328.

Në këtë formë data 15 nëntor në mbishkrim mund të korespondojë realisht me datën e pushtimit, por jo viti Gregorian. Për rrjedhojë, a mund të shohim në të një gabim të gdhendësit ? Ndoshta kemi një shënim të gabuar të datës nga gdhendësi, bazuar në kalendarin e Hixhrit, por duke ruajtur vitin e kalendarit Gregorian. Ndoshta, si në hamendësimin e parë, kjo gjë mund ta ketë bërë të papërdorshëm mbishkrimin, duke sjellë nevojën e një të dyti, që nuk ka arritur të ruhet.

Në fund mund të themi se megjithë mospërputhjet mes dy teksteve të mbishkrimeve greqisht dhe serbisht, dhe të paqartësive mbi datën e dhënë, prania e këtij mbishkrimi ka rëndësi për atë çka nënkupton. Mbishkrimi na tregon se qartësisht ka pasur një marrëdhënie të fshehtë mes mitropolitit Jakov dhe ushtrive serbe në dëm të interesave të Shqipërisë. Bashkëpunim, i cili nuk ka munguar të shprehet haptazi me rastin e pushtimit serb të qytetit, me siguri, bazuar në idenë e arritjes në mënyrë përfundimtare të synimeve të përbashkëta serbo-greke, pushtimin tërësor të trojeve shqiptare dhe zhdukjen e mundësisë për të pasur një shtet të pavarur shqiptar. Ky qëllim shpjegon edhe përgatitjen e një mbishkrimi të tillë, i cili është paraqitur në gjuhën e pushtuesit serb, dhe në gjuhën e mitropolitit, por jo në atë shqipe, dhe aq më pak në osmanisht. Mungesa e tekstit në shqip duhet të ketë disa qëllime. Kuptohet se mospërdorimi i shqipes është tregues për mospranimin e ekzistencës së kësaj gjuhe. Në këtë formë, duke barazuar gjuhën me kombësinë, mund të nënkuptohet edhe mosnjohja e një kombi shqiptarë, duke përdorur vetëm termin gjeografik Shqipëri në versionin greqisht. Për më tepër, synohej të ishte i lexueshëm nga ushtria serbe dhe pjesa progreke në qytet. Një tjetër synim mund të jetë përcaktimi i ushtrive serbe si çlirues nga Perandoria Osmane, dhe jo lufta e vetë shqiptarëve, jo vetëm duke i dekurajuar, por edhe duke i shtyrë banorët ortodoksë të pranonin ushtritë serbe, dhe t'i përkrahnin si vëllezër të së njëjtës fe, që po sillnin largimin e të pafeve.

Megjithëse i sjellë në Muzeun Arkeologjik të Durrësit, pasi duket se ky mbishkrim është konsideruar një objekt arkeologjik, në të vërtetë kemi të bëjmë me një dokument historik me vlerë për historinë e Shqipërisë.

**EDUARD SHEHI**

ΑΝΑΣΣΟΝΤΟΣ ΣΕΡΒΙΑΣ  
 ΠΕΤΡΟΥ Α΄ ΚΑΡΑΓΙΩΡΓΙΕΒΙΤΣ  
 ΕΠΙ ΜΗΤΡΟΠΟΛΙΤΟΥ ΔΥΡΡΑΧΙΟΥ ΙΑΚΩΒΟΥ  
 Η ΕΠΙ ΑΛΒΑΝΙΑ,  
 ΣΟΥΜΑΔΙΚΗ ΣΕΡΒΙΚΗ ΣΤΡΑΤΙΑ  
 ΥΠ ΑΡΧΗΓΩ, ΣΥΝΤΑΓΜΑΤΑΡΧΗ, Δ. ΜΠΟΥΛΙΤΣ  
 ΤΟ ΔΥΡΡΑΧΙΟΝ ΚΑΙ ΤΗΝ ΠΕΡΙΕ ΧΩΡΑΝ  
 ΑΠΟ ΤΟΥ ΤΟΥΡΚΙΚΟΥ ΖΥΓΟΥ  
 ΕΥΔΟΚΙΑ, ΘΕΟΥ ΗΛΕΥΘΕΡΩΣΕ  
 ΜΗΝΙ ΝΟΕΜΒΡΙΩ, 15 ΙΝΔΙΚΤΩΝΟΣ ΙΑ΄ 1912

За владе српског краља Петра I  
 Карађорђевића, а под митрополитом Драчком  
 Јаковом, српски шумадски албански одред  
 под командом пуковника Д. Булића ослободи  
 Драч и околне крајеве од турског јарма  
 15 новембра 1912 год.